



qendra e provimeve

MASA
E VËRTETË
E NJOHURIVE

GARAT SHTETËRORE 2022

SHIFRA E NXËNËSIT

SHKOLLA E MESME, KLASA III dhe IV

HISTORI

NUMRI I PËRGJITHSHËM I PIKËVE TË FITUARA

Testin e kontrolloi

Podgoricë, 20.....

UDHËZIME PËR GARUESIT:

- të gjithë garuesit fillojnë të punojnë testin në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën hapësirë,
- çdo garues është i ulur vetëm në bankën shkollore,
- testi zgjat një orë e gjysmë (90 minuta),
- ndalohet prezantimi i rrejshëm i garuesve,
- ndalohet përdorimi i telefonave celularë gjatë punës në test,
- ndalohet biseda me garuesit tjerë derisa zgjat testi,
- mbi bankë garuesi mund të ketë vetëm testin e shtypur me pyetje, lapsin kimik (një laps tjetër rezervë),
- mbikëqyrësi në test mund t'ju lejojë garuesve që mbi bankë të mbajnë edhe një shishe me ujë dhe peceta letre nëse e vlerësojnë që kjo është e domosdoshme,
- testi plotësohet vetëm me laps kimik (me ngjyrë të kaltër ose të zezë),
- ndalohet përmirësimi i përgjigjeve të cilat janë dhënë, përgjigjja që është shkruar ose rrethuar nuk guxon të përmirësohet, në qoftë se kjo do të bëhet përgjigjja nuk do të pranohet,
- para fillimit të testit mbikëqyrësi i testit e ka për detyrë që garueseve t'u kumtojë rregullat e punës në test dhe sjelljet në klasë,
- kontrolluesi shënon pikët dhe bën intervenimet tjera me rastin e vlerësimit të testit me laps kimik (me ngjyrë të kuqe).

Të dashur garues,

Para fillimit të zhvillimit të testit lexoni me kujdes çdo pyetje, pastaj i zgjidhni ato.

Ju dëshirojmë sukses të plotë në punën Tuaj.

Pyetjet e testit të historisë për vitin 2022.

- 1.** Ndryshimet graduale në kuptimin e rolit të njeriut në shoqëri dhe rezistenca e shprehur ndaj botëkuptimit mesjetar për botën, përhapja e shkrim-leximit, zhvillimi i qyteteve dhe rritja e pasurisë në Evropën e shekujve XIV-XVI çoi në shfaqjen e Humanizmit dhe Renesancës në Italinë Veriore. Ajo periudhë lindi krijues të shumtë kulturorë (shkencëtarë, piktorë, filozofë, skulptorë, arkitektë, shkrimtarë etj.).

Detyra jote është: mbi vija shkruaj emrat e autorëve të disa veprave të njohura letrare, filozofike-politike dhe shkencore.

- a) *Historia e Firencës* **Nikollo Makijaveli**
- b) *Utopia* **Tomas Mori**
- c) *Për përbërjen e trupit të njeriut* **Andreas Vezalijus**
- d) *Rreth orbitës së trupave qiellorë* **Nikolla Koperniku**

(4 pikë)

- 2.** Plotëso tekstin me përgjigje të sakta:

Kolonët në zonën kufitare të Monarkisë së Habsburgëve dhe Perandorisë Turke formuan një zonë mbrojtëse të quajtur **krahinë ushtarake** (1). Për kryerjen e shërbimit ushtarak, kolonët morën tokë dhe kishin statusin **fshatarëve të lirë** (2).

(2 pikë)

- 3.** Ndarjet në rritje midis katolikëve dhe protestantëve çuan në konflikte të rënda që ndodhën në Francë për pothuajse të gjithë shekullin XVI.

Detyra jote është: shkruaj përgjigjet e sakta mbi vija

- a) si quheshin protestantët në Francë? **Hugenotët.**
- b) në cilin vit u zhvillua "Nata e Bartolomeut"? **Në viti 1572.**
- c) cila dinasti sundoi Francën gjatë "Natës së Bartolomeut"? **Dinastia Valoa.**
- d) cilin vit u miratua Edikti i Nantit? **Në viti 1598.**

(4 pikë)

4. Plotëso përgjigjet e kërkuara:

Me përfundimin formal të pavarësisë shtetërore të Malit të Zi në vitin **1499** (1), rolin e institucionit qendror kombëtar, në fakt organit suprem politik për zgjidhjen e çështjeve më të rëndësishme të shoqërisë malazeze, e mori **tubimi gjithë malazez** (2). Takimet zakonisht janë mbajtur pranë Manastirit të Cetinës një herë në vit, ditën kur është edhe shenjtori i famshëm **Dita e Shën Pjetrit (pranohet edhe 12 korriku)**. (3).

(3 pikë)

5. “Edhe pse ne si aleatë fituam betejën e madhe detare të kundërshtarit të përbashkët nga Lindja, mosmarrëveshjet tona gjithnjë e më të mëdha çuan në faktin se ne do të kërkojmë paqen me sulltanin turk në emrin tonë. Në paqe, ne do t’ia dorëzojmë sulltanit turk ishullin për të cilin bëmë një luftë trevjeçare, por në këtë mënyrë do të fitojmë tregti të lirë me Lindjen”.

Shënim: megjithëse teksti është imagjinar, ai flet për ngjarjet dhe konfliktet reale të koalicionit të krishterë kundër Perandorisë Turke në shekullin XVI.

Detyra jote është: shkruaji përgjigjet e sakta mbi vija

- ku u zhvillua beteja e madhe detare? **Në Lepanta.**
- në cilin vit u zhvillua beteja? **Në viti 1571.**
- cili shtet i krishterë ishte i pari që doli nga koalicioni dhe bëri paqe me Perandorinë Turke? **Venediku (pranohet edhe Republika e Venedikut)**
- cili ishull i madh në Detin Mesdhe i përkiste Perandorisë Turke? **Qiproja**
- kush ishte veziri i madh i Perandorisë Turke në kohën e këtyre ngjarjeve?
Mehmet – pasha Sokolloviq

(5 pikë)

6. Periudha nga viti 1598 deri në 1613 njihet si “periudha e të vetëshpallurve” ose periudha e “kohëve të trazuara” në Rusi. Luftimet e brendshme për fronin e lirë ishin të ashpra, perandorët e vetëshpallur shpesh zëvendësoheshin dhe një shtet fqinj imponoi pretenduesin e tij në fushatat ushtarake.

Detyra jote është: shkruaji përgjigjet e sakta mbi vija

- cila dinasti ruse pushoi së sunduari në vitin 1598? **Rurikoviç**
- cili shtet fqinj ndërhyri drejtpërdrejt në luftën për fronin? **Polonia**
- cila dinasti ruse filloi të sundonte në vitin 1613? **Romanov**

(3 pikë)

7. Në shekujt XVI dhe XVII, Perandoria Turke kishte një sistem të fortë feudal dhe një administratë të organizuar mirë e cila udhëhiqte me perandorinë.

Detyra jote është: mbi vijat bosh pas numrave rendorë të kolonës së majtë, shkruaji shkronjat e duhura fillestare përpara termave nga kolona e djathtë për të marrë përgjigjet e sakta.

Shënim: një term nga kolona e djathtë është i tepërt

- | | |
|------------------------------|---|
| 1. muselim (mudiri) c | a) pasuri e madhe toke, pasuria e sulltanit |
| 2. hasi a | b) monedha të vogla prej argjendi |
| 3. akça (aspra) b | c) administrator i nahijes |
| 4. kadillëku d | d) zona administrative dhe juridike |
| 5. sanxhaku g | e) komandant i garnizonit ushtarak |
| 6. dizdari e | f) pronë e vogël toke |
| | g) zona administrative-territoriale |

(6 pikë)

8. Gjatë sundimit të Luigjit XIV, Franca ndoqi një politikë të jashtme dhe të brendshme shumë aktive.

Detyra jote është: mbi vija pas numrave rendorë të kolonës së majtë, shkruani shkronjat e duhura fillestare përpara ngjarjes nga kolona e djathtë për të fituar renditjen e saktë kronologjike:

- | | |
|-------------|--|
| 1. c | a) shfuqizimi i Ediktit të Nantit |
| 2. e | b) fillimi i luftës për trashëgiminë spanjolle |
| 3. d | c) fillimi i luftës holandeze |
| 4. a | d) marrjen e Strasburgut dhe Luksemburgut |
| 5. b | e) zhvendosja e oborrit në Versaj. |

(4 pikë)

9. Në fund të shekullit XVII në bregdetin malazez ka një rritje të vullshme të ndërtimit të kishave, si dhe në ndërtimet profane dhe depërtimit të barokut, i cili vjen në shprehje të plotë vetëm në Bokën e Kotorrit.

Detyra jote është: shkruaji përgjigjet e sakta mbi vija:

Pallati i famshëm **Bujoviq** (1) është ndërtesa më e rëndësishme profane barok në Perast dhe në të sot ndodhet një muze. Në Kotorr, në pallatin barok të **Gërgurit** (2), sot ndodhet Muzeu Detar. Në vitin 1910 në Cetinë është përfunduar ndërtesa e **Shtëpisë së Qeverisë** (3) e cila gjithashtu është punuar në stilin barok.

(3 pikë)

10. Kur monarkia absolutiste në Francë u shndërrua në një diktaturë të të privilegjuarve, të gjitha klasat jo të privileguara donin rrëzimin e saj. Shteti nuk arriti të dilte nga problemet financiare dhe as të realizonte reformat e premtuara, që ishte rruga drejt revolucionit të ardhshëm.

Detyra jote është: shkruaji përgjigjet e sakta mbi vija

- a) në cilat klasa kryesore u nda popullsia e Francës në prag të revolucionit? **3 (tri)**
- b) në cilin vit u miratua “Deklarata e të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit”? **Në viti 1789.**
- c) në cilin vit u shpall Republika e parë **Në viti 1792.**
- d) cila dinasti u rrëzua nga fronin me shpalljen e Republikës? **Burbonët**
- e) cila parti politike vendos diktaturën menjëherë pas shpalljes së republikës? **Jakobinët**

(5 pikë)

11. **Detyra jote është:** shkruaji përgjigjet e sakta mbi vija

Menjëherë pas kthimit nga Peçuja, ku u shugurua, peshkopi malazet **Danillo I Petroviq** (1) filloi aktivitetet kishtarë dhe politike që zgjuan dyshimin e Perandorisë Turke. Ai rindërtoi manastirin e shkatërruar të Cetinës, i cili u shkatërrua gjatë konfliktit në luftën e **Moresë** (2). Me perandorin rus **Petrin I Romanov** (3) bashkëpunoi në plane të përbashkëta për pjesëmarrjen e të krishterëve nga Ballkani në luftën kundër Perandorisë Turke duke ngritur kryengritje. Duke ndërhyrë në rrethana të brendshme në Republikën e Venedikut, u krijua institucioni **i guvernadurës** (4) nëpërmjet të cilit venedikasin ushtronin ndikim mbi disa udhëheqës malazet.

(4 pikë)

12. Me Kryengritjen e Parë dhe të Dytë Serbe, populli serb filloi luftën çlirimtare dhe luftën për pavarësi kombëtare kundër Perandorisë Turke.

Detyra jote është: sipas rendit kronologjik, shkruaji pranë numrave rendorë në kolonën e majtë shkronjat fillestare para ngjarjes nga kolona e djathtë që të fitosh renditjen e saktë kronologjike.

- 1. **c** a) fitorja e kryengritësve serbë në Mishar dhe Deligrad

2. **f** b) Paqja e Bukureshtit
3. **a** c) marrëveshja në Orashac
4. **b** d) vrasja e Karagjorgjes
5. **g** e) Konventa e Akermanit
6. **d** f) fitorja e kryengritësve serbë në Ivankovc
7. **e** g) Kryengritja e Haxhi-Prodanit

(6 pikë)

13. Napoleon Bonaparti bëri luftëra dhe fushata të shumta pushtuese, por kreu edhe reforma të shumta të shoqërisë franceze, të cilat e bënë Francën një nga vendet më të fuqishme në Evropë dhe në botë.

Detyra jote është: që ngjarjet e numëruara rastësisht t'i radhitësh sipas rendit kronologjik duke shkruar pranë numrave rendorë në kolonën e majtë shkronjat fillestare para ngjarjeve të dhëna nga kolona e djathtë që të fitosh renditjen e saktë:

1. **c** a) beteja e Marengës
2. **a** b) konkordati me kishën katolike
3. **b** c) paqja në Kampoforni
4. **e** d) beteja e Austerlicit
5. **d** e) Kodeksi i Napoleonit (kodi)
6. **g** f) beteja e Smolenskut
7. **f** g) shpallja e Dekretit të Berlinit (futja e bokadës kontinentale)

(6 pikë)

14. Detyra jote është: që ngjarjet e numëruara rastësisht gjatë sundimit të Petrit I Petroviq dhe Petrit II Petroviq – Njegosh t'i radhitësh sipas rendit kronologjik duke shënuar pranë numrave rendorë të kolonës së majtë shkronjat fillestare para ngjarjeve të dhëna nga kolona e djathtë që të fitosh renditjen e saktë

1. **c** a) shpallja e “Shtrëngimit”
2. **a** b) shpallja e bashkimit të Malit të Zi dhe Bokës,
3. **b** c) marshimi i Mahmut –pashë Bushatit në Cetinë
4. **f** d) themelimi i shtypshkronjës
5. **e** e) heqja e guvernatorit
6. **d** f) aneksimi i Rovacit dhe Moraçës në Mal të Zi
7. **g** g) arritja e paqes me Ali-pashë Rizvanbegoviçin

(6 pikë)

15. Lexo tekstin: “Le të dridhen klasat sunduese para revolucionit komunist. Në të, proletarët nuk kanë asgjë për të humbur përveç prangave të tyre. Dhe do të fitojnë të gjithë botën. Proletarët e të gjitha vendeve bashkohuni.”

Shënim: teksti është pjesë e një dokumenti programor, i cili përveç thirrjes së proletarëve për një revolucion botëror, është njëkohësisht edhe program i një organizate të njohur që u themelua pak para shpalljes dhe miratimit të dokumentit.

Detyra jote është: shkruaji përgjigjet e sakta mbi vija

- a) si quhet organizata për të cilën është shkruar ky dokument programor?
Lidhja Komuniste
- b) si quhet dokumenti programor?
“Manifesti i Partisë Komuniste”
- c) në cilin vit është publikuar dhe shtypur dokumenti i programit? **Në viti 1848.**
- d) në cilin qytet është themeluar organizata dhe u publikua dokumenti i programit?
Në Londër.
- e) në cilën gjuhë është shkruar dokumenti i programit, i cili më vonë është përkthyer pothuajse në të gjitha gjuhët botërore? **Në gjuhën gjermane.**

(5 pikë)

16. Lexo tekstin: “... nga dita e parë e janarit, të gjithë personat që mbahen si skllavër në një shtet apo rajon të caktuar si pjesë e atij shteti, janë dhe do të jenë të lirë përgjithmonë, dhe ata që pas kësaj date vazhdojnë t’i mbajnë në mënyrë të tillë, do të konsiderohet se janë në rebelim kundër shtetit.”

Shënim: kjo proklamata e njohur për heqjen e skllavërisë në një shtet u plotësua nga amendamenti XIII dy vjet më vonë, kur skllavëria është hequr përfundimisht.

Detyra jote është: shkruaji përgjigjet e sakta mbi vija

- a) si quhej presidenti dhe krijuesi i proklamatës?
Abraham Linkolni
- b) gjatë cilës luftë është shpallur proklamata?
Lufta Qytetare në SHBA
- c) në cilin vit përfundoi lufta dhe u miratua amendamenti XIII? **Në viti 1865.**
- d) si quhej organizata sekrete e cila u themelua pas përfundimit të luftës dhe cila , ndër të tjera, nuk pranoi heqjen e skllavërisë?
Kjus Kluks Klan (pranohet edhe: KKK)

(4 pikë)

17. Lexo tekstin: “... ne nuk shikojmë liberalizmin e Prusisë, por në fuqinë e tij ... Problemet e mëdha të epokës sonë nuk zgjidhen nga fjalimet apo vendimet e shumicës ... por me hekur dhe gjak.”

Shënim: këto fjalë i tha një politikan dhe kryeministër i njohur duke shpjeguar synimet e tij për krijimin e një shteti modern dhe të ri të fuqishëm.

Detyra jote është: shkruaji përgjigjet e sakta mbi vija

- a) si quhej politikanin dhe kryeministri? **Oto fon Bizmark**
- b) cili mret prusian ishte në krye të Prusisë kur u shpallën këto plane?
Viljem I Hoencolern (pranohet edhe: Viljem I)
- c) në cilin vit u shpall perandoria e re e bashkuar pas fitores së Prusisë?
Në viti 1871.
- d) cili vend ishte mundur më parë në luftë? **Francë**
- e) cili sundimtar ishte në krye të shtetit të mundur? **Napoleoni III**

(5 pikë)

18. Gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX u zhvillua drejtimi kulturor e artistik i realizmit. Në letërsi, realizmi ka arritur arritjet më të larta në Rusi.

Detyra jote është: që mbi vija të shkruash emrat dhe mbiemrat e autorëve të veprave letrare

- a) *Revizori* **Nikolaj V. Gogoli**
- b) *Shënimet e gjahtarit* **Ivan S. Turgenjevi**
- c) *Kozakët* **Lav N. Tolstoji**
- d) *Krimi dhe ndëshkimi* **Fjodor M. Dostojevski**

(4 pikë)

19. Detyra jote është: ngjarjet e dhëna rastësisht nga Lufta e Parë Botërore renditi sipas rendit kronologjik, duke shkruar pas numrave rendorë të kolonës së majtë shkronjat fillestare përpara ngjarjeve të dhëna nga kolona e djathtë për të fituar renditjen e saktë.

1. **c** a) beteja e Kollubarës

2. **a** b) beteja e Mojkovacit
3. **b** c) beteja e Tanenbergut
4. **e** d) beja e Jutlandës
5. **d** e) fillimi i ofensivës gjermane në Verden
6. **g** f) paqja në Brest-Litovsk
7. **f** g) depërtimi austro-hungarez dhe gjerman pranë Kobaridit

(6 pikë)

20. Deri në futjen e diktaturës së gjashtë janarit në Mal të Zi kishte disa parti politike që kishin gazetat e tyre si media zyrtare partiake.

Detyra jote është: që mbi vija të shkruash emrat e partive të cilat kanë shtypur dhe botuar gazetat e tyre për një kohë të gjatë ose të shkurtër.

- a) *Mali i Zi* **Partia Popullore Radikale**
- b) *Fjala e popullit* **Partia Demokratike**
- c) *Zëri i popullit* **Lidhja e Bujqve**
- d) *Malazezi* **Partia Malazeze (pranohet edhe: Partia e Federalistëve Malazez)**

(4 pikë)

21. Detyra jote është: ngjarjet e dhëna rastësisht nga Lufta e Dytë Botërore renditi sipas rendit kronologjik, duke shkruar pas numrave rendorë të kolonës së majtë shkronjat fillestare përpara ngjarjeve të dhëna nga kolona e djathtë për të fituar renditjen e saktë:

- 1) **g** a) miratimi i Kartës së Atlantikut
- 2) **a** b) sulmi i Japonisë në Perl Harbor
- 3) **b** c) kapitullimi i ushtrisë së 6-të gjermane në Stalingrad
- 4) **f** d) zbarkimi i aleatëve në Sicili
- 5) **c** e) beteja e gjirit Lejte,
- 6) **d** f) pushtimi i Krimesë dhe Sevastopolit nga gjermanët
- 7) **e** g) sulmi gjerman mbi Mbretërinë e Jugosllavisë

(6 pikë)

22. Mbi vija shkruaji përgjigjet e sakta:

Në fund të vitit 1941, në territorin e Malit të Zi u formua një milici (xhandarmëri) antikomuniste, e cila ishte nën kujdesin italian dhe ishin të njohur me emrin **“krahët”** (1). Gjatë shtatorit dhe tetorit të vitit 1941, është formuar organizata çetnilke. Komandimi mbi trupat në pjesën jugore dhe qendrore të Malit të Zi iu dha **major Gjorgjije Llashiq** (2) ndërsa komandimi i trupave në veri të Malit të Zi iu besua **kapitenit Pavle Gjurishiq** (3).

(3 pikë)

23. Mbi vijat shkruaji përgjigjet e sakta.

Aleanca e NATO-s u themelua në vitin **1949** (1). Mali i Zi u bë anëtar i aleancës së NATO-s në vitin **2017** (2).

(2 pikë)